



Prishtinë: 21 nëntor 2008  
Kodi i ZRRE-së: V\_136\_2008

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh,

1. Mandatin e tij ligjor të përcaktuar në Nenet 15 dhe 26 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9 të amendamentuar me ligjin Nr. 03/L-080;
2. Dispozitat e Nenet 11 e), f), g), 12.4 dhe 18.4 të Ligjit mbi Energjinë Nr 2004/8;
3. Neni 3 të Rregullit mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve);
4. Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2007 “Mbi Caqet Indikative për Konsumin e Energjisë Elektrike dhe Ngrohjes nga Burimet e Ripërtrithshme dhe Bashkëprodhimi”; dhe
5. Nenin 5 të Vendimit Nr 05/250 të Qeverisë së Kosovës mbi “Masat nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtrithshme dhe burimet e energjisë elektrike nga bashkëprodhimi në Kosovë për periudhën 2007-2013”

**Në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2008 nxori këtë:**

#### VENDIM

- I. Përcaktohen** tarifat nxitëse (**feed-in**) për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e vogla.

#### Arsyetim

1. Vendimi bazohet në:
  - Raportin Konsultativ të ZRRE-së mbi Shqyrtimin e Feed-in Tarifave për energji elektrike të prodhuar nga hidrocentralet e vogla, lëshuar më 15 shtator 2008,
  - Shqyrtimin e Feed-in Tarifave për hidrocentralet e vogla- Përgjigje ndaj komenteve të Raportit Konsultativ të ZRRE-së, lëshuar më 20 tetor 2008,
2. Tarifat nxitëse **feed-in** për hidrocentralet e vogla sipas kapaciteteve të lokacioneve janë në pajtueshmëri me Vendimin Nr 05/250 Neni 5 të Qeverisë së Kosovës, dhe iu referohen kapaciteteve në lokacionet përkatëse të specifikuar në studimin “Studimi i parafizibilitetit për identifikimin e burimeve ujore për hidrocentrale të vegjël në Kosovë” të Shoqatës Shqiptare të Energjisë dhe Mjedisit për Zhvillim të Qëndrueshëm (SHSHEMZHQ).



Struktura e tarifave nxitëse **feed-in** duket si më poshtë:

<i>Kapaciteti i HCV</i>	<i>Çmimi</i> <i>(€cent/kWh)</i>
<i>Hidrocentrale deri në 2 MW</i>	<i>6.7</i>
<i>Hidrocentrale nga 2 MW deri në 5 MW</i>	<i>5.9</i>
<i>Hidrocentrale nga 5 MW deri në 10 MW</i>	<i>5.6</i>

3. Këto tarifa vlejné për një periudhë 10 vjeçare.
4. Vendimi nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe;
5. Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda 14 ditëve nga data e miratimit dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Nysret Avdiu, anëtar